

URDHËR
Nr. 293, datë 26.7.2019

PËR SHPALLJEN E DISA NDRYSHIMEVE TË STANDARDIT NDËRKOMBËTAR TË KONTABILITETIT NR. 1 “PARAQITJA E PASQYRAVE FINANCIARE”, STANDARDIT NDËRKOMBËTAR TË KONTABILITETIT NR. 8 “POLITIKAT KONTABËL, NDRYSHIMET NË VLERËSIMET KONTABËL DHE GABIMET”, STANDARDIT NDËRKOMBËTAR TË KONTABILITETIT NR. 10 “NGJARJE PAS PERIUDHËS SË RAPORTIMIT”, STANDARDIT NDËRKOMBËTAR TË KONTABILITETIT NR. 34 “RAPORTIMI FINANCIAR I NDËRMJETËM”, STANDARDIT NDËRKOMBËTAR TË KONTABILITETIT NR. 37 “PROVIZIONET, DETYRIMET DHE AKTIVET E KUSHTËZUARA”, STANDARDIT NDËRKOMBËTAR TË RAPORTIMIT FINANCIAR NR. 3 “KOMBINIME BIZNESI”, TË KUADRIT KONCEPTUAL PËR RAPORTIMIN FINANCIAR TË 2010-s DHE TË KUADRIT KONCEPTUAL PËR RAPORTIMIN FINANCIAR TË 2018-s

Në mbështetje të nenit 3, pika 4, të ligjit nr. 25/2018 “Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare”, të vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 505, datë 17.7.2019 “Për miratimin e rregullores së organizimit dhe të funksionimit të Këshillit Kombëtar të Kontabilitetit”,

URDHËROJ:

1. Shpalljen e disa ndryshimeve të Standardit Ndërkombëtar të Kontabilitetit nr. 1 “Paraqitja e Pasqyrave Financiare” (SNK 1), Standardit Ndërkombëtar të Kontabilitetit nr. 8 “Politikat kontabël, Ndryshimet në vlerësimet kontabël dhe gabimet” (SNK 8), Standardit Ndërkombëtar të Kontabilitetit nr. 10 “Ngjarje pas Periudhës së Raportimit” (SNK 10), Standardit Ndërkombëtar të Kontabilitetit nr. 34 “Raportimi Financiar i Ndërmjetëm” (SNK 34), Standardit Ndërkombëtar të Kontabilitetit nr. 37 “Provizionet, Detyrimet dhe Aktivët e Kushtëzuara” (SNK 37), Standardit Ndërkombëtar të Raportimit Financiar nr. 3 “Kombinime Biznesi” (SNRF 3), të Kuadrit Konceptual për Raportimin Financiar të 2010 dhe të Kuadrit Konceptual për Raportimin Financiar të 2018.

2. Ndryshimet e SNK 1, SNK 8, SNK 10, SNK 34, SNK 37, SNRF 3, Kuadrit Konceptual për Raportimin Financiar të 2010 dhe Kuadrit Konceptual për Raportimin Financiar të 2018, të publikuara në vitin 2018, kanë datë efektive 1 janar 2020 dhe do të zbatohen në prospektivë.

3. Ky urdhër hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

MINISTËR I FINANCAVE
DHE EKONOMISË
Anila Denaj

PËRKUFIZIMI I MATERIALITETIT
NDRYSHIME NË SNK 1 DHE SNK 8

Ndryshime në SNK 1 *Paraqitja e Pasqyrave Financiare*

Bordi po publikon dy versione të tij për ndryshimet në përkufizimin e materialitetit në SNK 1 për të lejuar zbatimin më herët të këtij ndryshimi pavarësisht nga zbatimi i Ndryshimeve për Referencat në Kuadrin Konceptual në Standardet e SNRF-ve.

Është ndryshuar paragrafi 7 për një njësi ekonomike që nuk ka zbatuar ndryshimet e vitit 2018 të Referencave për Kuadrin Konceptual në Standardet e SNRF-ve dhe është shtuar paragrafi 139T. Teksti i ri është i nënvizuar dhe teksti i fshirë është bërë me vijë në mes.

7 ...

Materialiteti:

~~Mangësitë apo anomalitë e elementëve janë materiale (të rëndësishme) nëse ato mund të ndikojnë, në mënyrë individuale ose në grup, vendimet ekonomike që marrin përdoruesit mbi bazën e pasqyrave financiare. Materialiteti varet nga madhësia dhe natyra e mangësive ose anomalive të gjykuara nga rrethanat më të afërta. Përmasat dhe natyra e elementit, ose kombinimi i të dyjave, mund të jetë faktor përcaktues.~~

Informacioni është material nëse mungesa, paraqitja e gabuar ose e paqartë, ka pritshmëri të arsyeshme që të ndikojë në vendimet që përdoruesit kryesorë të pasqyrave financiare të përgjithshme mund të marrin në bazë të atyre pasqyrave financiare, të cilat japin informacion financiar rreth një njësie ekonomike të caktuar.

Materialiteti varet nga natyra ose madhësia e informacionit, ose të dyja bashkë. Një njësi ekonomike vlerëson nëse informacioni, individualisht ose në kombinim me informacione të tjera, është material në kontekstin e pasqyrave financiare të marra në tërësi.

Informacioni është i paqartë nëse komunikohet në një mënyrë që do të kishte një efekt të ngjashëm për përdoruesit kryesorë të pasqyrave financiare sikur të mos ishte dhënë fare apo të ishte dhënë me gabime. Në vijim jepen disa shembuj të rrethanave që mund të rezultojnë në fshehjen e informacionit që është material:

(a) informacioni në lidhje me një element, transaksion ose ngjarje tjetër materiale është dhënë në pasqyrat financiare por gjuha e përdorur është e turbullt ose e paqartë;

(b) informacioni në lidhje me një element, transaksion apo ngjarje tjetër materiale është i shpërndarë në të gjitha pasqyrat financiare;

(c) elemente pa ngjashmëri me njëri tjetrin, apo transaksione ose ngjarje të tjera janë të grupuara në mënyrë të papërshtatshme;

(d) elemente të ngjashëm, apo transaksione ose ngjarje të tjera janë raportuar veçmas (të ndara) në mënyrë të papërshtatshme; dhe

(e) kuptueshmëria e pasqyrave financiare është zvogëluar si rezultat i fshehjes së informacionit material duke dhënë informacione jo materiale në atë masë sa që një përdorues kryesor nuk është në gjendje të përcaktojë se çfarë informacioni është material dhe çfarë jo.

Vlerësimi nëse një informacion ose një mangësi apo gabim ka pritshmëri të arsyeshme që mund të ndikojë në vendimet ekonomike e marra nga përdoruesit kryesorë të pasqyrave financiare të një njësie raportuese të caktuar, dhe kështu të jetë material, kërkon që një njësi ekonomike të marrë parasysh karakteristikat e këtyre përdoruesve, ndërkohë që duhet të marrë parasysh dhe rrethanat e vetë njësisë ekonomike.

Shumë investitorë ekzistues dhe potencialë, hua dhënës apo kreditorë të tjerë nuk mund t'i kërkojnë njësisë ekonomike raportuese të japë informacion në mënyrë të drejtpërdrejtë për ta por duhet të bazohen në pasqyrat financiare për qëllime të përgjithshme për shumicën e informacionit financiar që ata kanë nevojë. Si rrjedhim, ata janë përdoruesit kryesorë, të cilëve i'u drejtohen këto pasqyra financiare për qëllime të përgjithshme. Pasqyrat financiare hartohen për përdoruesit të cilët kanë një njohuri të arsyeshme të biznesit dhe të veprimtarive ekonomike dhe që shqyrtojnë dhe analizojnë informacionin me kujdes. Në të njëjtën kohë, edhe përdoruesit e mirinformuar dhe të kujdesshëm mund të kenë nevojë të kërkojnë ndihmën e një këshilltari për të kuptuar informacionin në lidhje me dukuritë ekonomike komplekse.

~~Kuadri për Përgatitjen dhe Paraqitjen e Pasqyrave Financiare parashikon në paragrafin 25² se 'përdoruesit supozohet se kanë njohje të arsyeshme të veprimtarisë ekonomike dhe biznesit dhe të kontabilitetit dhe një dëshirë për të studiuar informacionin me kujdesin e duhur.' Për këtë arsye, vlerësimi duhet të marrë parasysh se si përdoruesit me attribute të tilla mund të ndikohen në marrjen e vendimeve ekonomike.~~

² Në Shtator 2010, BSNK zëvendësoi *Kuadrin* me *Kuadrin Konceptual për Raportimin Financiar*. Paragrafi 25 është zëvendësuar nga kapitulli 3 i *Kuadrin Konceptual*

...

Data e hyrjes në fuqi

...

139T Përkufizimi i Materialitetit (Ndryshimet në SNK 1 dhe SNK 8), publikuar në tetor 2018, ndryshuan paragrafin 7 të SNK 1 dhe paragrafin 5 të SNK 8 dhe fshinë paragrafin 6 të SNK 8. Një njësi ekonomike do t'i zbatojë këto ndryshime në mënyrë prospektive për periudhat vjetore që fillojnë më datën 1 janar 2020 e në vijim. Lejohet zbatimi përpara kësaj date. Nëse një njësi ekonomike i zbaton këto ndryshime për një periudhë më të hershme, ajo do të japë informacione shpjeguese për këtë fakt.

Është ndryshuar paragrafi 7 për një njësi ekonomike që ka zbatuar ndryshimet e vitit 2018 të *Referencave për Kuadrin Konceptual në Standardet e SNRF-ve* dhe është shtuar paragrafi 139T. Teksti i ri është i nënvizuar dhe teksti i fshirë është bërë me vijë në mes.

Përkufizime

7

...

Materialiteti:

~~Mangësitë apo anomalitë e elementëve janë materiale (të rëndësishme) nëse ato mund të ndikojnë, në mënyrë individuale ose në grup, vendimet ekonomike që marrin përdoruesit mbi bazën e pasqyrave financiare. Materialiteti varet nga madhësia dhe natyra e mangësive ose anomalive të gjykuara nga rrethanat më të afërta. Përmasat dhe natyra e elementit, ose kombinimi i të dyjave, mund të jetë faktor përcaktues.~~

Informacioni është material nëse mungesa, paraqitja e gabuar ose e paqartë, ka pritshmëri të arsyeshme që të ndikojë në vendimet që përdoruesit kryesorë të pasqyrave financiare të përgjithshme mund të marrin në bazë të atyre pasqyrave financiare, të cilat japin informacion financiar rreth një njësie ekonomike të caktuar.

Materialiteti varet nga natyra ose madhësia e informacionit, ose të dyja bashkë. Një njësi ekonomike vlerëson nëse informacioni, individualisht ose në kombinim me informacione të tjera, është material në kontekstin e pasqyrave financiare të marra në tërësi.

Informacioni është i paqartë nëse komunikohet në një mënyrë që do të kishte një efekt të ngjashëm për përdoruesit kryesorë të pasqyrave financiare sikur të mos ishte dhënë fare apo të ishte dhënë me gabime. Në vijim jepen disa shembuj të rrethanave që mund të rezultojnë në fshehjen e informacionit që është material:

(a) informacioni në lidhje me një element, transaksion ose ngjarje tjetër materiale është dhënë në pasqyrat financiare por gjuha e përdorur është e turbullt ose e paqartë;

(b) informacioni në lidhje me një element, transaksion apo ngjarje tjetër materiale është i shpërndarë në të gjitha pasqyrat financiare;

(c) elemente pa ngjashmëri me njëri tjetrin, apo transaksione ose ngjarje të tjera janë të grupuara në mënyrë të papërshtatshme;

(d) elemente të ngjashëm, apo transaksione ose ngjarje të tjera janë raportuar veçmas në mënyrë të papërshtatshme; dhe

(e) kuptueshmëria e pasqyrave financiare është zvogëluar si rezultat i fshehjes së informacionit material duke dhënë informacione jo materiale në atë masë sa që një përdorues kryesor nuk është në gjendje të përcaktojë se çfarë informacioni është material dhe çfarë jo.

Vlerësimi nëse një informacion ose një mangësi apo gabim ka pritshmëri të arsyeshme që mund të ndikojë në vendimet ekonomike të marra nga përdoruesit kryesorë të pasqyrave financiare të një njësie raportuese të caktuar, dhe kështu të jetë material, kërkon që një njësi ekonomike të marrë parasysh karakteristikat e këtyre përdoruesve, ndërkohë që duhet të marrë parasysh dhe rrethanat e vetë njësisë ekonomike. Përdoruesit supozohet se kanë një njohuri të arsyeshme të aktiviteteve ekonomike dhe ekonomike dhe të kontabilitetit dhe gatishmërinë për të studiuar informacionin me kujdesin e duhur. Për këtë arsye, vlerësimi duhet të marrë parasysh se si përdoruesit me attribute të tilla mund të ndikohen në marrjen e vendimeve ekonomike.

Shumë investitorë ekzistues dhe potencialë, hua dhënës dhe kreditorë të tjerë nuk mund t'i kërkojnë njësisë ekonomike raportuese të japë informacion në mënyrë të drejtpërdrejtë për ta por duhet të bazohen në pasqyrat financiare për qëllime të përgjithshme për shumicën e informacionit financiar që ata kanë nevojë. Si rrjedhim, ata janë përdoruesit kryesorë, të cilëve i'u drejtohen këto pasqyra financiare për qëllime të përgjithshme. Pasqyrat financiare hartohen për përdoruesit të cilët kanë një njohuri të arsyeshme të biznesit dhe të veprimtarive ekonomike dhe që shqyrtojnë dhe analizojnë informacionin me kujdes. Në të njëjtën kohë, edhe përdoruesit e mirinformuar dhe të kujdesshëm mund të kenë nevojë të kërkojnë ndihmën e një këshilltari për të kuptuar informacionin në lidhje me dukuritë ekonomike komplekse.

...

Data e hyrjes në fuqi

...

139T *Përkufizimi i Materialitetit* (Ndryshimet në SNK 1 dhe SNK 8), publikuar në tetor 2018, ndryshuan paragrafin 7 të SNK 1 dhe paragrafin 5 të SNK 8 dhe fshinë paragrafin 6 të SNK 8. Një njësi ekonomike do t'i zbatojë këto ndryshime në mënyrë prospektive për periudhat vjetore që fillojnë më datën 1 janar 2020 e në vijim. Lejohet zbatimi përpara kësaj date. Nëse një njësi ekonomike i zbaton këto ndryshime për një periudhë më të hershme, ajo do të japë informacione shpjeguese për këtë fakt.

Ndryshimet në SNK 8 *Politikat kontabël, Ndryshimet në vlerësimet kontabël dhe gabimet*

Bordi po lëshon dy versione të tij për ndryshimet në përkufizimin e materialitetit në SNK 8 për të lejuar zbatimin më herët të këtij ndryshimi pavarësisht nga zbatimi i Ndryshimeve për Referencat në Kuadrin Konceptual në Standardet e SNRF-ve.

Është ndryshuar paragrafi 5 për një njësi ekonomike që nuk ka zbatuar ndryshimet e vitit 2018 të <i>Referencave për Kuadrin Konceptual në Standardet e SNRF-ve</i> . Paragrafi 6 është fshirë dhe është shtuar paragrafi 54H. Teksti i ri është i nënvizuar dhe teksti i fshirë është bërë me vijë në mes.
--

Përkufizime

5 ...

Materialiteti Mungesa ose deklarime të gabuara të zërave janë materiale nëse ato në mënyrë individuale ose kolektive mund të ndikojnë vendimet ekonomike të përdoruesve, vendime këto të marra në bazë të pasqyrave financiare. Materialiteti varet nga madhësia dhe natyra e mangësive ose anomalive të gjykuara nga rrethanat më të afërta. Madhësia

ose natyra e një elementi, ose kombinim i të dyjave, mund të jetë faktori përcaktues. është përcaktuar në paragrafin 7 të SNK 1 dhe përdoret në këtë Standard me të njëjtin kuptim.

...

6 Për të vlerësuar nëse një mungesë apo anomali mund të ndikojë në vendimet ekonomike të përdoruesve, si rrjedhim të jetë materiale, kërkon të merren parasysh karakteristikat e këtyre përdoruesve. *Kuadri për Përgatitjen dhe Paraqitjen e Pasqyrave Financiare* parashikon në paragrafin 25² se 'përdoruesit supozohet se kanë njohje të arsyeshme të veprimtarisë ekonomike dhe biznesit dhe të kontabilitetit dhe një dëshirë për të studiuar informacionin me kujdesin e duhur.' Për këtë arsye, vlerësimi duhet të marrë parasysh se si përdoruesit me attribute të tilla mund të ndikohen në marrjen e vendimeve ekonomike. [Fshirë]

² *Kuadri për Përgatitjen dhe Paraqitjen e Pasqyrave Financiare* i KSNK-së është miratuar nga BSNK në 2001. Në Shtator 2010 the BSNK zëvendësoi *Kuadrin* me *Kuadrin Konceptual për Raportimin Financiar*. Paragrafi 25 është zëvendësuar nga kapitulli 3 i *Kuadrin Konceptual*.

...

Data e hyrjes në fuqi

...

54H *Përkufizimi i Materialitetit* (Ndryshimet në SNK 1 dhe SNK 8), publikuar në tetor 2018, ndryshuan paragrafin 7 të SNK 1 dhe paragrafin 5 të SNK 8 dhe fshinë paragrafin 6 të SNK 8. Një njësi ekonomike do t'i zbatojë këto ndryshime në mënyrë prospektive për periudhat vjetore që fillojnë më datën 1 janar 2020 e në vijim. Lejohet zbatimi përpara kësaj date. Nëse një njësi ekonomike i zbaton këto ndryshime për një periudhë më të hershme, ajo do të japë informacione shpjeguese për këtë fakt.

Është ndryshuar paragrafi 5 për një njësi ekonomike që ka zbatuar ndryshimet e vitit 2018 të *Referencave për Kuadrin Konceptual në Standardet e SNRF-ve*. Paragrafi 6 është fshirë dhe është shtuar paragrafi 54H. Teksti i ri është i nënvizuar dhe teksti i fshirë është bërë me vijë në mes.

Përkufizime

5 ...

Materialiteti Mungesa ose deklarime të gabuara të zërave janë materiale nëse ato në mënyrë individuale ose kolektive mund të ndikojnë vendimet ekonomike të përdoruesve, vendime këto të marra në bazë të pasqyrave financiare. Materialiteti varet nga madhësia dhe natyra e mangësive ose anomalive të gjykuara nga rrethanat më të afërta. Madhësia ose natyra e një elementi, ose kombinim i të dyjave, mund të jetë faktori përcaktues. është përcaktuar në paragrafin 7 të SNK 1 dhe përdoret në këtë Standard me të njëjtin kuptim.

...

6 Për të vlerësuar nëse një mungesë apo anomali mund të ndikojë në vendimet ekonomike të përdoruesve, si rrjedhim të jetë materiale, kërkon të merren parasysh karakteristikat e këtyre përdoruesve. Përdoruesit supozohet se kanë një njohuri të arsyeshme të aktiviteteve ekonomike dhe ekonomike dhe të kontabilitetit dhe gatishmërinë për të studiuar informacionin me kujdesin e duhur. Për këtë arsye, vlerësimi duhet të marrë parasysh se si përdoruesit me attribute të tilla mund të ndikohen në marrjen e vendimeve ekonomike. [Fshirë]

...

Data e hyrjes në fuqi

...

54H *Përkufizimi i Materialitetit* (Ndryshimet në SNK 1 dhe SNK 8), publikuar në tetor 2018, ndryshuan paragrafin 7 të SNK 1 dhe paragrafin 5 të SNK 8 dhe fshinë paragrafin 6 të SNK 8.

Një njësi ekonomike do t'i zbatojë këto ndryshime në mënyrë prospektive për periudhat vjetore që fillojnë më datën 1 janar 2020 e në vijim. Lejohet zbatimi përpara kësaj date. Nëse një njësi ekonomike i zbaton këto ndryshime për një periudhë më të hershme, ajo do të japë informacione shpjeguese për këtë fakt.

Ndryshime të tjera në Standardet SNRF dhe publikime **Ndryshime në *Kuadrin Konceptual për Raportimin Financiar* të 2010**

Ndryshimet në vijim janë pasojë e ndryshimeve në përkufizimin e materialitetit në SNK 1 dhe SNK 8. Këto ndryshime zbatohen në mënyrë prospektive, njëkohësisht një njësi ekonomike zbaton ndryshimet në përkufizimin e materialitetit në SNK 1 dhe në SNK 8.

Është ndryshuar paragrafi KC11. Teksti i ri është i nënvizuar dhe teksti i fshirë është bërë me vijë në mes.

Materialiteti

KC11 Informacioni është material nëse mungesa, paraqitja e gabuar, ose e paqartë, ka pritshmëri të arsyeshme që mund të ndikojë në vendimet që përdoruesit kryesorë të raporteve financiare për qëllime të përgjithshme (shikoni paragrafin OB5) mund të marrin në bazë të atyre raporteve, të cilat japin informacion financiar rreth një njësie ekonomike të caktuar. Me fjalë të tjera, materialiteti është një aspekt i veçantë, në një njësi ekonomike, në funksion të natyrës ose madhësisë, ose i të dyjave, të zërave me të cilat lidhet informacioni në kontekstin e raportimit financiar të një njësie ekonomike individuale. Për rrjedhojë, Bordi nuk mund të specifikojë një kufi sasior unik për materialitetin apo të paracaktojë se çfarë mund të jetë materiale në një situatë të veçantë.

Ndryshime në *Kuadrin Konceptual për Raportimin Financiar* të 2018

Ndryshimet në vijim janë pasojë e ndryshimeve në përkufizimin e materialitetit në SNK 1 dhe SNK 8. Këto ndryshime zbatohen në mënyrë prospektive, njëkohësisht një njësi ekonomike zbaton ndryshimet në përkufizimin e materialitetit në SNK 1 dhe në SNK 8.

Është ndryshuar paragrafi 2.11. Teksti i ri është i nënvizuar dhe teksti i fshirë është bërë me vijë në mes.

Materialiteti

2.11 Informacioni është material nëse mungesa, paraqitja e gabuar, ose e paqartë ka pritshmëri të arsyeshme që mund të ndikojë në vendimet që përdoruesit kryesorë të raporteve financiare për qëllime të përgjithshme (shikoni paragrafin 1.5) mund të marrin në bazë të atyre raporteve, të cilat japin informacion financiar rreth një njësie ekonomike të caktuar. Me fjalë të tjera, materialiteti është një aspekt i veçantë, në një njësi ekonomike, në funksion të natyrës ose madhësisë, ose i të dyjave, të zërave me të cilat lidhet informacioni në kontekstin e raportimit financiar të një njësie ekonomike individuale. Për rrjedhojë, Bordi nuk mund të specifikojë një kufi sasior unik për materialitetin apo të paracaktojë se çfarë mund të jetë materiale në një situatë të veçantë.

Ndryshime në SNK 10 Ngjarje pas Periudhës së Raportimit

Paragrafi 21 është ndryshuar dhe është shtuar paragrafi 23C. Teksti i ri është i nënvizuar dhe teksti i fshirë është bërë me vijë në mes.

Ngjarje që nuk korrigjohen pas periudhës raportuese

21 Nëse ngjarjet që nuk kërkojnë rregullim pas periudhës raportuese janë materiale, mos dhënia e informacioneve shpjeguese ka pritshmëri të arsyeshme që mund të ndikojë në vendimet ekonomike që përdoruesit kryesorë të pasqyrave financiare të përgjithshme marrin mbi bazën e këtyre pasqyrave financiare, të cilat ofrojnë informacion financiar për një njësi ekonomike raportuese të caktuar. Si rrjedhim, një njësi ekonomike do të jap informacionin e mëposhtëm shpjegues për secilën kategori materiale të ngjarjeve të pakorrigjueshme pas datës së periudhës raportuese:

(a) natyra e ngjarjes; dhe

(b) një vlerësim të efektit të saj financiar, ose një deklaratë që një vlerësim i tillë nuk mund të bëhet.

...

Data e hyrjes në fuqi

...

23C Përkufizimi i Materialitetit (Ndryshimet për SNK 1 dhe SNK 8), publikuar në Tetor 2018, ka ndryshuar paragrafin 21. Një njësi ekonomike do t'i zbatojë këto ndryshime në mënyrë prospektive për periudhat vjetore që fillojnë më datën 1 janar 2020 e në vijim. Lejohet zbatimi përpara kësaj date. Nëse një njësi ekonomike i zbaton këto ndryshime për një periudhë më të hershme, ajo do të japë informacione shpjeguese për këtë fakt. Një njësi ekonomike do të zbatojë këto ndryshime kur zbaton ndryshimet në përkufizimin e materialitetit në paragrafin 7 të SNK 1 dhe paragrafët 5 dhe 6 të SNK 8.

Ndryshime në SNK 34 Raportimi Financiar i Ndërmjetëm

Paragrafi 24 është ndryshuar dhe është shtuar paragrafi 58. Teksti i ri është i nënvizuar dhe teksti i fshirë është paraqitur me vijë në mes.

Materialiteti

...

~~24 SNK 1 dhe SNK 8 Politikat Kontabël, Ndryshimet në Çmuarjet Kontabël dhe Gabimet e përcakton një zë si material në qoftë se mungesa ose keq-paraqitja e tij do të influenconte në vendimet ekonomike të përdoruesve të pasqyrave financiare. SNK 1 kërkon një informacion dhe kërkon dhënien e shpjegimeve të veçanta për zërat material, duke përfshirë (për shembull) operacionet jo të vijueshme dhe SNK 8 Politikat Kontabël, Ndryshimet në Çmuarjet Kontabël dhe Gabimet kërkon dhënien e informacioneve për ndryshimet në çmuarjet kontabël, gabimet dhe ndryshimet në politikat kontabël. Të dy Standardet nuk përmbajnë udhëzime të natyrës sasiore përsa i përket materialitetit.~~

...

Data e hyrjes në fuqi

...

58 Përkufizimi i Materialitetit (Ndryshimet për SNK 1 dhe SNK 8), publikuar në Tetor 2018, ka ndryshuar paragrafin 24. Një njësi ekonomike do t'i zbatojë këto ndryshime në mënyrë prospektive për periudhat vjetore që fillojnë më datën 1 janar 2020 e në vijim. Lejohet zbatimi përpara kësaj date. Nëse një njësi ekonomike i zbaton këto ndryshime për një periudhë më të hershme, ajo do të japë informacione shpjeguese për këtë fakt. Një njësi ekonomike do të zbatojë këto ndryshime kur zbaton ndryshimet në përkufizimin e materialitetit në paragrafin 7 të SNK 1 dhe paragrafët 5 dhe 6 të SNK 8.

Ndryshime në SNK 37 Provizionet, Detyrimet dhe Aktivet e Kushtëzuara

Paragrafi 75 është ndryshuar dhe është shtuar paragrafi 104. Teksti i ri është i nënvizuar dhe teksti i fshirë është paraqitur me vijë në mes.

Ristrukturimi

75 Një vendim i drejtimt ose bordit për të ristrukturuar, i marrë përpara fundit të periudhës raportuese, nuk çon në krijimin e një detyrimi konstruktiv në datën e periudhës raportuese përveçse kur njësia ekonomike përpara datës së periudhës raportuese:

- (a) ka filluar të zbatojë planin e ristrukturimit; ose
- (b) ka komunikuar planin e ristrukturimit tek palët e prekura prej tij në një mënyrë mjaft specifike për të bërë një parashikim të vlefshëm për sa i përket kryerjes së ristrukturimit nga njësia ekonomike.

Në qoftë se një njësi ekonomike fillon të zbatojë një plan ristrukturimi, ose njofton tiparet kryesore tek ata që preken prej tij, vetëm pas periudhës raportuese, sipas SNK 10 *Ngjarjet pas Periudhës së Raportimit*, kërkohet të jepen informacione shpjeguese, në qoftë se ristrukturimi është material dhe mosdhënia e informacioneve shpjeguese ka prishmëri të arsyeshme të mund të influenconte vendimet ekonomike që përdoruesit kryesorë të pasqyrave financiare të përgjithshme do merrnin në bazë të atyre pasqyrave financiare, të cilat ofrojnë informacion financiar për një njësi raportuese specifike.

Data e hyrjes në fuqi

104 Përkufizimi i Materialitetit (Ndryshimet për SNK 1 dhe SNK 8), publikuar në Tetor 2018, ka ndryshuar paragrafin 75. Një njësi ekonomike do t'i zbatojë këto ndryshime në mënyrë prospektive për periudhat vjetore që fillojnë më datën 1 janar 2020 e në vijim. Lejohet zbatimi përpara kësaj date. Nëse një njësi ekonomike i zbaton këto ndryshime për një periudhë më të hershme, ajo do të japë informacione shpjeguese për këtë fakt. Një njësi ekonomike do të zbatojë këto ndryshime kur zbaton ndryshimet në përkufizimin e materialitetit në paragrafin 7 të SNK 1 dhe paragrafët 5 dhe 6 të SNK 8.

Përkufizimi i biznesit

Ndryshime në SNRF 3

Ndryshime në SNRF 3 *Kombinime biznesi*

Paragrafi 3, përkufizimi i termit "biznes" në shtojcën A dhe paragrafët B7-B9, B11 dhe B12 janë ndryshuar. Janë shtuar paragrafët 64P, B7A-B7C, B8A dhe B12A-B12D, dhe titujt mbi paragrafët B7A, B8 dhe B12. Paragrafi B10 është fshirë. Teksti i ri është i nënvizuar dhe teksti i fshirë është bërë me vijë në mes.

Identifikimi i një kombinimi biznesi

3 Një njësi ekonomike do të përcaktojë nëse një transaksion ose një ngjarje tjetër është një kombinim biznesi duke zbatuar përkufizimin në këtë SNRF, i cili kërkon që aktivet e blera dhe detyrimet e supozuara përbëjnë një biznes. Nëse aktivet e blera nuk janë një biznes, njësia ekonomike raportuese do të trajtojë transaksionin apo ngjarjen tjetër si një blerje aktivesh. Paragrafët B5-B12 B12D japin udhëzime për identifikimin e një kombinim biznesi dhe përkufizimin e një biznesi.

Data e hyrjes në fuqi dhe periudha kalimtare

Data e hyrjes në fuqi

64P Përkufizimi i një biznesi, i publikuar në tetor 2018, shtoi paragrafët B7A-B7C, B8A dhe B12A-B12D, ndryshoi përkufizimin e termit "biznes" në shtojcën A, ndryshoi paragrafët 3, B7-

B9, B11 dhe B12 dhe është fshirë paragrafi B10. Një njësi ekonomike do të zbatojë këto ndryshime për ato kombinime biznesi për të cilat data e blerjes është në datën e fillimit të periudhës së parë të raportimit vjetor që fillon në 1 janar 2020 ose më pas dhe për ato blerje aktive që kanë ndodhur në fillim të kësaj periudhe ose më pas. Lejohet zbatimi i këtyre ndryshimeve për periudha më të hershme. Nëse një njësi ekonomike i zbaton këto ndryshime për një periudhë më të hershme, ajo do të japë informacione shpjeguese për këtë fakt.

Shtojca A Termat e përkufizuara

...
biznesi Një grup i integruar i aktiviteteve dhe aktiveve që është i aftë për t'u kryer dhe për t'u menaxhuar me qëllim ofrimin e mallrave ose shërbimeve tek klientët, duke krijuar të ardhura nga investimet (si p.sh., dividend ose interes) ose krijimin e të ardhurave të tjera nga aktivitete të zakonshme të një kthimi në formën e dividendëve, kostove më të ulëta ose përfitime të tjera ekonomike për investitorët direkt ose pronarët e tjerë, anëtarët ose pjesëmarrësit.

Përkufizimi i një biznesi (zbatimi i paragrafit 3)

B7 Një biznes përbëhet nga inputet dhe proceset që aplikohen mbi to të cilat kanë aftësinë të krijojnë kontribuojnë në krijimin e produkteve. Edhe pse zakonisht bizneset kanë produkte, produktet nuk janë të kërkuara për një set të integruar për tu kualifikuar si biznes. Tre elementet e një biznesi përcaktohen si më poshtë (shih paragrafët B8-B12D për udhëzime mbi elementet e një biznesi):

(a) **Input:** Çdo burim ekonomik që krijon produkte, ose ka aftësinë për të krijuar kontribuar në krijimin e produkteve, kur mbi të zbatohen një ose më shumë procese. Shembujt përfshijnë aktivet afatgjata (duke përfshirë aktivet jomateriale ose të drejtat për të përdorur aktivet afatgjata), pronën intelektuale, aftësinë për të pasur akses tek burimet materialet të nevojshme ose tek të drejtat pasurore dhe tek të punësuarit.

(b) **Proces:** Çdo sistem, standard, protokoll, parim ose rregull që, kur zbatohen në një input ose inute, krijon produkte ose ka aftësinë për të krijuar kontribuar në krijimin e produkteve. Shembujt përfshijnë proceset strategjike të menaxhimit, proceset operacionale dhe proceset e menaxhimit të burimeve. Këto procese zakonisht janë të dokumentuara, por kapaciteti intelektual i një force punëtore të organizuar që ka aftësitë e nevojshme dhe përvojën duke ndjekur rregullat dhe parimet mund të ofrojë proceset e nevojshme për t'u zbatuar në inute për të krijuar produkte. (Kontabiliteti, faturimi, listën e pagave dhe sistemet e tjera administrative zakonisht nuk janë proceset që përdoren për të krijuar produkte.)

(c) **Produkti:** Është rezultati i inuteve dhe proceseve të aplikuara mbi ato inute që krijojnë ose kanë aftësinë për të siguruar një kthim në formën e dividendëve, kostove më të ulëta ose përfitime të tjera ekonomike drejtpërdrejt për investitorët ose pronarët e tjerë, anëtarët ose pjesëmarrësit mallra ose shërbime për klientët, të ardhura nga investimet (si p.sh., dividendët, ose interesat) ose krijojnë të ardhura të tjera nga veprimtari të zakonshme.

Test fakultativ për të identifikuar përqendrimin e vlerës së drejtë

B7A Paragrafi B7B përcakton një test opsional (testin e përqendrimit) për të lejuar një vlerësim të thjeshtuar nëse një grup aktivitets dhe aktiveve të blera nuk janë një biznes. Një njësi ekonomike mund të zgjedhë të aplikojë ose jo këtë test. Një njësi ekonomike mund të bëjë një zgjedhje të tillë veçmas për çdo transaksion ose ngjarje tjetër. Testi i përqendrimit ka pasojat e mëposhtme:

(a) nëse plotësohen kushtet e metodës së përqendrimit, grupi i aktiviteteve dhe aktiveve përcaktohet të mos jetë biznes dhe kështu nuk nevojitet vlerësim i mëtejshëm.

(b) nëse kushtet e metodës së përqendrimit nuk plotësohen, ose nëse njësia zgjedh që të mos aplikojë testin, atëherë njësia do të kryejë vlerësimin e përcaktuar në paragrafët B8-B12D.

B7B Testi i përqendrimit plotësohet nëse në thelb e gjithë vlera e drejtë e aktiveve bruto të blera është e përqendruar në një aktiv të identifikueshëm ose grup aktivesh të ngjashme dhe të identifikueshme. Për testin e përqendrimit:

(a) në aktivet bruto të blera nuk përfshihen mjetet monetare dhe ekuivalentët e saj, aktivet tatimore të shtyra dhe emri i mirë që rrjedh nga efektet e detyrimeve tatimore të shtyra.

(b) vlera e drejtë e aktiveve bruto të blera do të përfshijë çdo shumë të transferuar (plus vlerën e drejtë të ndonjë interesi jokontrollues dhe vlerën e drejtë të çdo interesi të mbajtur më parë) që tejkalojnë vlerën e drejtë të aktiveve neto të identifikueshme të blera. Vlera e drejtë e aktiveve bruto të blera normalisht mund të përcaktohet si totali i përfituar duke i shtuar vlerën e drejtë të shumës së transferuar (plus vlerën e drejtë të ndonjë interesi jokontrollues dhe vlerën e drejtë të çdo interesi të mbajtur më parë) vlerës së drejtë të detyrimeve të supozuara (përveç detyrimeve tatimore të shtyra), dhe pastaj duke përjashtuar artikujt e identifikuar në nënparagrafin (a). Megjithatë, nëse vlera e drejtë e aktiveve bruto të blera është më shumë se totali i përfituar, ndonjëherë mund të nevojitet llogaritje më e saktë.

(c) një aktiv i vetëm i identifikueshëm do të përfshijë çdo aktiv ose grup aktivesh që do të njihen dhe maten si një aktiv i vetëm i identifikueshëm në një kombinim biznesi.

(d) nëse një aktiv material është i bashkëngjitur dhe që nuk mund të hiqet fizikisht dhe të përdoret i ndarë nga një aktiv tjetër material (ose nga një aktiv kryesor i dhënë me qira siç përcaktohet në SNRF 16 *Qiratë*) pa kosto të konsiderueshme ose zvogëlim të ndjeshëm të vlerës së përdorimit të secilit aktiv (për shembull, toka dhe ndërtesat), ato aktive konsiderohen si një aktiv i vetëm i identifikueshëm.

(e) kur vlerëson nëse aktivet janë të ngjashme, një njësi ekonomike do të marrë parasysh natyrën e çdo aktivi të vetëm të identifikueshëm dhe rreziqet që lidhen me menaxhimin dhe krijimin e produkteve nga këto aktivet (domethënë karakteristikat e rrezikut).

(f) nuk do të konsiderohen si aktive të ngjashme:

(i) një aktiv material dhe një aktiv jomaterial;

(ii) aktivet materiale në klasa të ndryshme (p.sh. inventari, pajisjet prodhuese dhe mjete transporti) përveç nëse ato konsiderohen si një aktiv i vetëm i identifikueshëm në përputhje me kriterin e nënparagrafit (d);

(iii) aktivet jo materiale të identifikueshme në klasa të ndryshme (për shembull, emrat e markave, licencat dhe aktivet jo materiale në proces);

(iv) një aktiv financiar dhe një aktiv jofinanciar;

(v) aktivet financiare në klasa të ndryshme (për shembull, llogaritë e arkëtueshme dhe investimet në instrumente të kapitalit neto); dhe

(vi) aktive të identifikueshme që janë brenda të njëjtës klase, por në mënyrë të dukshme kanë karakteristika të ndryshme të rrezikut.

B7C Kërkesat në paragrafin B7B nuk ndryshojnë udhëzimin për aktivet e ngjashme sipas SNK 38 *Aktivet Jomateriale*; dhe as nuk e ndryshojnë kuptimin e termit “klasë” në SNK 16 *Aktivet Afatgjata Materiale*, SNK 38 dhe SNRF 7 *Instrumentet Financiare; Dhënia e Informacioneve shpjeguese*.

Elementet e një biznesi

B8 Edhe pse zakonisht bizneset kanë produkte, produktet nuk janë të domosdoshme për një grup të integruar aktivitetesh për t'u kualifikuar si biznes. Që një grup i integruar i aktiviteteve dhe aktiveve të quhen të aftë për t'u zhvilluar dhe menaxhuar sipas qëllimit e përcaktuar të identifikuar në përkufizimin e biznesit, kërkon dy elemente thelbësor - inputet dhe proceset për t'u aplikuar mbi këto inpute, të cilat së bashku janë ose do të përdoret për të krijuar rezultate. Megjithatë, Një biznes nuk ka nevojë të përfshijë të gjitha inputet ose proceset që shitësi përdor gjatë aktivitetit të biznesit nëse pjesëmarrësit e tregut janë të aftë për të blerë biznesin dhe duke vazhduar për të prodhuar produkte, për shembull, duke integruar biznesin me inputet dhe proceset e tyre. Megjithatë, për t'u konsideruar si një biznes, një grup aktivitetesh dhe aktivesh të integruar duhet të përfshijnë, të paktën një input dhe një proces thelbësor që së bashku të

kontribuojnë ndjeshëm në aftësinë për të krijuar produkt. Paragrafët B12-B12D specifikojnë se si të vlerësohet nëse një proces është thelbësor.

B8A Nëse në një grup aktiviteteve dhe aktiveve të blera ka produkte, vazhdimësia e të ardhurave nuk tregon në vetvete që janë blerë të dyja, inputi dhe procesi thelbësor.

B9 Natyra e elementeve të një biznesi ndryshon në varësi të industrisë dhe nga struktura e operacioneve të njësisë ekonomike (aktivitetet), duke përfshirë edhe fazën e zhvillimit të njësisë ekonomike. Bizneset e krijuara shpesh kanë shumë lloje të ndryshme të inputeve, proceseve dhe produkteve, ndërsa bizneset e reja shpesh kanë pak inpute dhe procese dhe nganjëherë vetëm një produkt të vetëm. Pothuajse të gjitha bizneset kanë detyrime por një biznes nuk ka nevojë të ketë detyrime. Për më tepër, një grup aktiviteteve dhe aktiveve të blera që nuk janë biznes mund të kenë detyrime.

~~B10 Një grup i integruar aktiviteteve dhe aktiveve në fazën e zhvillimit mund të mos kenë rezultate. N.q.s. jo, blerësi duhet të marrë në konsideratë faktorë të tjerë për të përcaktuar nëse grupi i aktiveve është një biznes. Këto faktorë përfshijnë por nuk kufizohen vetëm në, nëse:~~

- ~~(a) kanë filluar aktivitetet kryesore të planifikuara;~~
 - ~~(b) Ka punonjës, pasuri intelektuale dhe inpute dhe procese të tjera që mund të aplikohen mbi këto inpute;~~
 - ~~(c) Po ndjek një plan për të prodhuar një produkt; dhe~~
 - ~~(d) do të ketë akses tek konsumatorët të cilët do të blejnë produktet.~~
- ~~Jo të gjithë këto faktorë duhet të jenë të pranishëm për një grup të veçantë të integruar të veprimtarive dhe aktiveve në fazën e zhvillimit që të kualifikohen si një biznes. [Fshirë]~~

B11 Për të përcaktuar nëse një grup i veçantë i aktiviteteve dhe i aktiveve është një biznes duhet do të bazohemi nëse grupi i integruar është i aftë të zhvillohet dhe të menaxhohet si një biznes nga pjesëmarrësit e tregut. Kështu, në vlerësimin nëse një grup i veçantë është një biznes apo jo, nuk është e rëndësishme nëse një shitës e drejton grupin e aktiveve si një biznes apo nëse blerësi ka për qëllim për të vepruar me grupin si një biznes.

Vlerësimi nëse një proces i blerë është thelbësor

~~B12 Në mungesë të provave për të kundërtën, një grup i veçantë aktiveve dhe veprimtarish në të cilat emri i mirë është i pranishëm, do të supozohet të jetë një biznes. Megjithatë, një biznes nuk ka nevojë të ketë emrin e mirë. Paragrafët B12A-B12D shpjegojnë se si të vlerësohet që një proces i blerë është i rëndësishëm nëse grupi i aktiviteteve dhe aktiveve të blera nuk kanë produkte (paragrafi B12B) dhe nëse ato kanë produkte (paragrafi B12C).~~

B12A Një shembull i një grupi aktiviteteve dhe aktiveve të blera që nuk kanë produkte në datën e blerjes është një njësi ekonomike në fillesat e hershme që nuk ka filluar të gjenerojë të ardhura. Për më tepër, nëse një grup i aktiviteteve dhe aktiveve të blera ka gjeneruar të ardhura në datën e blerjes, konsiderohet të ketë produkte në atë datë, edhe nëse më pas nuk do të gjenerojë të ardhura nga klientët e jashtëm, për shembull sepse ai do të integrohet brenda blerësit.

B12B Nëse një grup aktiviteteve dhe aktiveve nuk kanë produkte në datën e blerjes, një proces i blerë (ose grup procesesh) do të konsiderohet thelbësor vetëm nëse:

- (a) ai është i domosdoshëm për aftësinë për të zhvilluar ose kthyer një input ose inputet e blera në produkte; dhe
- (b) inputet e blera përfshijnë të dyja si forcën e punës të organizuar që ka aftësitë, njohuritë ose përvojën e nevojshme për të kryer atë proces (ose grup procesesh) ashtu dhe inpute të tjera që fuqia punëtore e organizuar mund t'i zhvillojë ose t'i konvertojë në produkte. Këto inpute të tjera mund të përfshijnë:

(i) pronën intelektuale që mund të përdoret për të zhvilluar një mall ose një shërbim;
(ii) burime të tjera ekonomike që mund të zhvillohen për të krijuar produkte; ose
(iii) të drejtat për të siguruar akses në materialet ose të drejtat e nevojshme që mundësojnë krijimin e produkteve të ardhshme.

Shembuj të inputeve të përmendura në nënparagrafët (b) (i) - (iii) përfshijnë teknologjinë, projektet e kërkimit dhe të zhvillimit në proces, pasuritë e patundshme dhe interesat minerare.

B12C Nëse një grup aktivitetesth dhe aktivesh ka produkte në datën e blerjes, një proces i blerë (ose grup procesesh) do të konsiderohet thelbësor nëse, kur zbatohet për një input ose inpute të blerë, procesi:

(a) është i domosdoshëm në lidhje me aftësinë për të vazhduar prodhimin e produkteve dhe inputet e blera përfshijnë një forcë pune të organizuar me aftësitë, njohuritë ose përvojën e nevojshme për të kryer këtë proces (ose grup procesesh); ose

(b) kontribuon ndjeshëm në aftësinë për të vazhduar prodhimin e produkteve dhe:

(i) konsiderohet i veçantë ose i rrallë; ose

(ii) nuk mund të zëvendësohet pa kosto, përpjekje apo vonesa të konsiderueshme në aftësinë për të vazhduar prodhimin e produkteve.

B12D

Diskutimi i mëtejshëm në vijim mbështet të dy paragrafët B12B dhe B12C:

(a) një kontratë e blerë është një input dhe jo një proces thelbësor. Sidoqoftë, një kontratë e blerë, për shembull, një kontratë për menaxhimin e pasurive të paluajtshme ose administrimin e aktiveve, mund të japë akses në një fuqi punëtore të organizuar. Një njësi ekonomike do të vlerësojë nëse fuqia punëtore e organizuar e hasur nëpërmjet një kontrate të tillë kryen një proces thelbësor që njësi ekonomike ka nën kontroll dhe rrjedhimisht ka blerë. Faktorët që duhet të merren parasysh në kryerjen e këtij vlerësimi përfshijnë kohëzgjatjen e kontratës dhe kushtet e rinovimit të saj.

(b) vështirësitë në zëvendësimin e një fuqie punëtore të organizuar të blerë më parë mund të tregojnë se fuqia punëtore e organizuar e blerë kryen një proces që është kritik në lidhje me aftësinë për të krijuar produkte.

(c) një proces (ose grup i procesesh) nuk është kritik nëse, për shembull, është ndihmues ose i parëndësishëm brenda kontekstit të të gjitha proceseve të kërkuara për të krijuar produkte.